



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



01-Nr 020/04- 22851 dt. 29-06 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 25 (1.6) të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçantë të Banimit, nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndërtimin e shtëpive

- I. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndërtimin e shtëpive janë:
 1. Feride Istogu (Kryetar),
 2. Albulena Lushtaku (Anëtarë),
 3. Bedri Morina (Anëtarë),
- II. Komisioni ka për detyrë:
 - a) Të shqyrtojë të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me çështjen e ndërtimit të shtëpisë,
 - b) Të formojë kriteret e nevojshëm – domosdoshme për këtë kategori,
 - c) Të verifikoj rastet,
 - d) Të klasifikojë rastet,
 - e) Të formuloj listën prioritare të nevojtareve për ndërtimin e shtëpive.
- III. Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndërtimin e shtëpive, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim.
- IV. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në

R.LI

një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.

- V. Ky komision në afat të arsyeshëm duhet të paraqes raport me shkrim si dhe rekomandime me listën prioritare, lidhur me vlerësimin e kërkesave për ndërtimin e shtëpive.
- VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorive përkatëse;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.